

V E N D I M

Nr. 1248, date 10. 09.2008

PËR SHPALLJEN E JAVËS SË UJIT NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, e 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen "Java e ujit në Shqipëri", të javës së parë, të muajit nëntor, të çdo viti.
2. Të gjitha institucionet shtetërore të fushës, në nivel qendror dhe vendor, si dhe shoqata e ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, veçmas ose në bashkëpunim, të programojnë, organizojnë dhe realizojnë, në këtë kuadër, brenda juridiksionit dhe mundësive të tyre financiare, infrastrukturën festive dhe veprimtari të ndryshme.
3. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore, të përmendura në pikën 2, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

SALI BERISHA